



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:138969

Datë: 30.07.2024

Numri i dokumentit: 06015308

KPPP.nr.631/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbareme të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike “KESCO” SH.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, kundër debitorit V.Z.S. B.I., me seli në Kamenicë, rruga “Dëshmorët e Kombit” p.n., përfaqësuar sipas autorizimit nga Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr.1029/18 të datës 09.11.2018, të lejuar nga Përmbaresi Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 30.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit V.Z.S. B.I., ANULOHET urdhri përmbareme P.nr.1029/18 i datës 09.11.2018 i Përmbaresit Privat Rushit Hoxha dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbareme.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike “KESCO” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbareme P.nr.1029/18 të datës 09.11.2018, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstrakt i verifikuar nga librat afarist Nr. DPZ-,,, duke obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të këtij urdhri t’ia paguajë kreditorit borxhin prej 1,669.89 €, me kamat ligjore prej 8 % nga dita e kalimit të afatit për pagese e deri në pagesën definitive, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbareme, në të kundërtën përmbushja e detyrimit nga ana e gjykatës të bëhet me dhunë, ashtu që përmbaremi të realizohet me bllokimin e llogarive bankare

të debitorit, si dhe sendet e luajshme të debitorit të regjistrohen, vlerësohen, sekuestrohen dhe të shiten deri në vlerën e borxhit.

Debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim, me te cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor duke theksuar se dokumenti i besueshëm mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarrimor është i parashkruar. Tutje ka shtuar se borxhi ka ardhur si pasoj e neglizhencës së zyrtareve të kreditorit, pasi që debitori ka bërë një pagesë në shumë prej 800.00 € për të njëjtin njësor në degën në Gjilan, kurse kreditori asnjëherë nuk e ka shlyer atë borxh, për këtë çështje debitori ka ushtruar ankesë pranë KESco por asnjëherë nuk ka marrë përgjigje. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit pasi që kërkesa është e parashkruar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se kërkesa është parashkruar, pasi që debitori për periudhën e kërkuar me propozim, ka zbutur borxhin e kërkuar duke bërë pagesa të kohëpaskohshme, duke bërë kështu ndërprerjen e parashkrimit. Tutje ka shtuar se kërkesa për prapësim nuk është në harmoni me nenin 69 të LPP-së, i njëjti është i paargumentuar dhe i pabazuar. I ka propozuar gjykatës që ta lë në fuqi urdhrin përmbarrimor.

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me këtë çështje përmbarrimore me Aktvendimin PPP.nr.89/2022 të datës 09.06.2022, ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.1029/18 të datës 09.11.2018.

Kreditori me datë 29.06.2022, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarrimore, konstatim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit, të ndryshohet aktvendimi i atakuar ashtu që të refuzohet prapësimi i debitorit ose të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimit Ac.nr.5057/2022 të datës 24.07.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr.89/2022 të datës 09.06.2022, të Gjykata Themelore në Prizren dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundojë në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm – Ekstrakti i Verifikuar nga librat afarist Nr. DPZ-,,, në bazë të së cilit është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.1 nën par. 1.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen: *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata vlerëson se Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist Nr. DPZ-,,, në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit nga librat afariste dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitori.

Gjykata deri te ky vlerësim erdhi pasi që nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist Nr. DPZ-,,, rezulton se borxhi para datës 19.05.2013, i është bartur debitorit si *“Trans >>>> 19.05.2013”*, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk janë përfshirë fare shërbimet dhe shuma e borxhit para periudhës së datës 19.05.2013, me ç' rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë, andaj si rrjedhojë ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Gjykata i vlerësoi edhe vërejtjet e dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, mirëpo meqenëse dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarimor nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm nuk u lëshua fare në shqyrtimin e parashkrimit.

Andaj gjykata vlerëson se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor në rastin konkret, nuk i ka tiparet e ekstraktit të verifikuar nga librat afariste dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.631/24, datë 30.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.